

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS, BERAT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Berat me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për vitin 2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 115, datë 15.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 575/8, date 15.09.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtore e Përgjithshme e Doganave, Tiranë dhe z. Evis Plaku Kryetar i Degës Doganës, Berat.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A-MASA ORGANIZATIVE

1. Realizimi i të ardhurave për vitin 2013, tregon për mos planifikim dhe mos ndjekje si duhet të planifikimit, veprime këto që nuk përputhen me kërkesat e pikës 4 të nenit 9, nenit 23 dhe 24 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe të kontrollit”, Detajimi në periudha mujore i planit të të ardhurave, kërkon një njohje më të mirë të situatës dhe zhdoganimeve të pritshëm. *Trajtuar në faqet 12-15 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Dega e Doganës Berat, të marrë masa të plota, për ndjekjen e realizimin e të ardhurave doganore nga një punonjës i caktuar, të cilat do të shërbejnë për një analizë më të shpejtë e të argumentuar sipas sektorëve dhe njësive përkatëse organizative.

2. Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm në momentin e auditimit paraqitet: Nga 13 masa për shpërblimin e demit në vlerë 17,336,064 lekë për 162 subjekte e persona, nga Dega e Doganës kanë dalë Vendimet në 19 raste për shumën 9,742,020 lekë nga ku janë arkëtuar 708,878 lekë, për 11 raste. *Trajtuar në faqen 12 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Dega e Doganës Berat të marrë masa që të mos ndërpriten ritmet për vazhdimin e rikuperimit të borxhit doganor të mbetur pa rikuperuar për të cilat kanë dale vendimet administrative **në vlerën prej 9,033,142 lekë**, e rekomanduar nga KLSH në auditimin e mëparshëm duke përdorur të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore.

3. Nga auditimi u konstatua se nuk disponohej dosje investigimi për subjekte të ndryshme, të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm e të nevojshëm, me qëllim pranimin e çmimit me transaksion, në përlllogaritjen e vlerës doganore, veprime që nuk përputhen me kërkesat e neneve 34-40 të KD, udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 si edhe me të dhënat e disponueshme të miratuara nga komisioni i Ministrisë së Financave.

Praktikat doganore, të realizuara nga Dega e Doganës Berat, nuk janë shoqëruar me procesverbal mbi vlerësimin e indikatorëve në kundërshtim me nenet 285, 286, 287 e vijim të Kodi Doganor, udhëzimin nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”. *Trajtuar në faqet 15-31 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Dega e Doganës Berat të marrë masa që praktikat doganore, të pranuar me transaksion në përcaktimin e vlerës për qëllime doganore, të mbështeten me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të neneve 285, 286, 287 e vijim të Kodi Doganor, si dhe të udhëzimit nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” pika 6, në të cilën thuhet: *“Përcaktimi i vlerës së artikullit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar...”* si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”.

4. Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni shoqërues i praktikave doganore, të pranuar për vlerësim nga administrata doganore, janë dokumente fotokopje si fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e paketimit, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007. Në praktikat doganore nuk janë bashkëlidhur librezat e mjeteve transportuese, apo certifikata e peshimit bosh me qëllim përcaktimin e saktë të peshës bosh (tarës) të mjetit, kapacitetit mbartës të tij, si dhe të peshës bruto e neto të mallit të importuar dhe eksportuar të pasqyruara në përlllogaritjen e shpenzimeve të transportit e të vlerës së mallit. *Trajtuar në faqet 15-31 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Dega e Doganës Berat, të marrë masa për ndalimin e menjëhershëm të përdorimit të dokumenteve shoqëruese të praktikave doganore që paraqiten për zhdoganim nga operatorët ekonomik dhe pranohen për vlerësim nga administrata doganore, në formën dokumente fotokopje të tilla si fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e paketimit në raste të veçanta edhe Euro 1, veprime këto që bien në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe udhëzimi nr. 25, datë 30.11.2007, I Ministrit të Financave.

5. Për mallrat të cilat nuk kanë të dhëna të disponueshme (apo të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD) si dhe për mallrat e përdorura nuk është nxjerrë urdhër nga dega doganore për miratimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit, ku për vendimet e marra nga ky komision duhej të ishte njoftuar menjëherë DPD, në zbatim të pikës 54-81 të VKM nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, udhëzimit nr. 6, 6/1/2 të DPD “Mbi vlerësimin doganor”. *Trajtuar në faqet 15-31 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Dega e Doganës Berat të nxjerrë menjëherë urdhrin e brendshëm për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit doganor, për të vlerësuar mallrat për të cilët nuk kanë të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD, si dhe për mallrat e përdorura.

6. Për të gjitha subjektet debitore nuk është marrë masë sekuestrimi për arkëtimin e detyrimit. Gjendja e borxhit doganor në nivele të larta e me tendencë në rritje, arkëtimi dhe vjelja e debitorëve në nivele të ulëta është rrjedhojë e një pune të pamjaftueshme në mos zbatimin e plotë të kërkesave të legjislacionit për rikuperimin e borxhit doganor, nga ana e autoritetit doganor kompetent dhe përbëjnë shkelje të: Kodit Doganor, Udhëzimit nr. 4, date 04.08.2006 “Për Zbatimin Praktik të Procedurës së Evidentimit, Kontabilizimit dhe Vjeljes së Borxhit Doganor me ndryshimet” dhe Rregullores së Brendshme të D.P. Doganave me nr. 10168 Prot. , datë 07.06.2011. *Trajtuar në faqet 45-47 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Nga autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Berat të analizohet gjendja e debitorëve , të përdoren të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore me program pune të posaçëm dhe me afate konkrete

dhe të merren të gjitha masat për rikuperimin e borxhit doganor të mbetur pa rikuperuar **në vlerën prej 297 438 mijë lekë.**

7. Në lidhje me zbatimin e procedurave të ligjit nr. 61/2012 dhe VKM dhe udhëzimeve të dala për zbatimin e tij konstatojmë; asnjë nga dosjet e subjekteve të akcizës nuk ka të inventarizuar materialin shkresor që gjenden në të; mungojnë aktrakordimet ndërmjet subjektit dhe zyrës së akcizës. *Trajtuar në faqet 55-62 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Dega e Doganës Berat të marrë masa për të kryer plotësimin e dosjeve dokumentare të të gjitha subjekteve që operojnë me akcizë.

8. Në lidhje me zbatimin e procedurave të ligjit nr. 61/2012 dhe VKM e udhëzimeve të dalë për zbatimin e tij konstatojmë; Kontrolli i zyrës doganore, specialistëve të akcizës, në terren, drejtpërsëdrejti në subjekte pothuajse ka munguar; Nuk është ushtruar asnjë kontroll në lidhje me zbatimin e kartës teknologjike për të parë realizimin e koeficientëve të shfrytëzimit të lëndës së parë dhe përcaktimin real e të saktë të produktit të gatshëm që përfitohet prej saj. Mos kryerja e kontrolleve direkt në subjekte, në terren, mos ndjekja në sistem dhe mos kryerja e rakordimeve në kohë me subjektet për të dhënat e akcizës ka bërë që shkeljet e konstatuara kanë rezultuar të shumta dhe me efekte financiare në mos realizimin e të ardhurave dhe shtimin e nivelit të borxhit do ganor. *Trajtuar në faqet 55-62 të Raportit të auditimit. Sa më sipër rekomandojmë:*

Dega e Doganës Berat të marra masa të menjëhershme që Sektori i Akcizës në bazë të një plani pune me afate konkrete. Të ndërtojë një raport më të drejtë të punës në terren dhe monitorimit të situatës nëpërmjet sistemit Asycuda World, për subjektet që operojnë me akcizë. Në mënyrë periodike të kryejë verifikimet (inventarët) dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabile. Të marrë masa në lidhje me sigurimin nga çdo operator ekonomik të kalibrimit të depozitave që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit të tyre sidomos subjekteve të pijeve alkoolike, verës.

B. MASA ADMINISTRATIVE

Dega e Doganës Berat, të analizojë e të nxjerrë përgjegjësitë administrative për shkeljet e legjislacionit në fuqi të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit duke i ndëshkuar subjektet me gjobë si më poshtë;

1. Në bashkëpunim me kontrollin a-posterior, zyra e regjimeve doganore të marrë masa; për penalizim me gjobë nga 50-200 mijë lekë, **të 3 (tre) subjekteve** që operojnë me regjim të përpunimit aktiv, të cilët kanë shkelur kërkesat e autorizimeve të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbasi kanë importuar dhe futur në përpunim artikuj jashtë kodeve të përcaktuara, në zbatim të ligjit nr. 8449 datë 27.01.1999 “ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë “ neni 256 pika 1 germa “a”, nenin 275 pika 1 dhe pika 2. Trajtuar në faqet 31-45 të Raportit të auditimit.

2. Në bashkëpunim me kontrollin a-posterior zyra e regjimeve doganore të marrë masa; për **2 (dy) subjekte** që operojnë me regjim të përpunimit aktiv dhe kanë shkelur kërkesat ligjore për mbylljen e autorizimeve, të cilat janë mbyllur me vonesë ose me dokumentacion jo të plotë, të klasifikojë shkeljet doganore dhe të aplikojë dënimin me gjobë mbështetur në ligjin Nr. 8449 datë 27.01.1999 “ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” neni 272 pika 1 dhe 2. Trajtuar në faqet 31-45 të Raportit të auditimit.

3. Në bashkëpunim me kontrollin a-posterior zyra e regjimeve doganore të marrë masa; që për **2 (dy) subjekte** që operojnë me regjim të përpunimit aktiv dhe kanë deklaruar në riekспорт vlera

plus në krahasim me vlerën në import të aplikojë dënimin sipas ligjit Nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë “ me ndryshimet, neni 261 pika 1. Trajtuar në faqet 31-45 të Raportit të Auditimit.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Dega e Doganës Berat, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë prej **25,489,507 lekë** si më poshtë:

a. Vlera prej **5,267,808 lekë**, nga **15 subjekte**, në **28 raste**, të trajtuar në faqet 15-31 të Raportit të auditimit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaliteteve sipas Kodit Doganor, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore.

b. Vlera prej **8.476,212 lekë** nga **20 subjekte**, të trajtuar në faqet 30-31 të Raportit të auditimit dhe anekseve 1-24, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të rentës Minerare.

c. Vlera prej **111,067 lekë**, nga **3 subjekte** të trajtuar në faqet 47-52 të Raportit të auditimit për mos llogaritje dhe mos arkëtim penalitet $\frac{1}{2}$ e detyrimit doganor deri në detyrimin e plotë të mallrave në kundërshtim me nenin 273.2 të Kodit Doganor.

d. Vlera prej **11 634 420 lekë**, nga **1 subjekt** për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimit prej 2 908 605 lekë dhe gjobë për shumën 8 725 815 lekë. Trajtuar në faqet 42-43 të Raportit të auditimit.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës, Berat, që në vlerësimin e shkeljeve të mëposhtme të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda e shumë të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhëroje fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse disiplinore, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, **për 3 punonjës** të Degës Doganës, Berat si më poshtë:

1. [REDAKTUAR].me detyrë ish doganier Vlerësim/Klasifikimi, aktualisht me detyrë doganier Akcize, Regjimesh, Preferenca, Përrjashtime, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale:

-Veprime në kundërshtim me kërkesat e neneve 34-40 të KD, të VKM-së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, me ndryshime. Për 27 raste sipas trajtimit në faqet 15-30 në Raportin Përfundimtar të Auditimit .

-Veprime në kundërshtim me Kodin Doganor nenet 108, 137,139, 140, 160 dhe 272; V.K.M. nr. 205 datë 13.04.1999 “ Për Miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor” nenet 274, 280, 282 dhe 300 dhe të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Nr.1 datë 06.09.2012.

- Veprime në kundërshtim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 neni 7, pika 1 “*inventari i aktiveve dhe detyrimeve*”. sipas trajtimit në faqet 31-44 në Raportin Përfundimtar të Auditimit . - Veprime në kundërshtim me ligjin 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 612, datë 05.09.2012.

2.me detyrë doganiere Akcize, Regjimesh, Preferenca, Përjashtime, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale:

-Veprime në kundërshtim me Kodin Doganor nenet 108, 137,139, 140, 160 dhe 272; V.K.M . nr. 205 datë 13.04.1999 “ Për M iratimin e Disp ozitave Zbatuese të Kodit Doganor” nenet 274, 280, 282 dhe 300 dhe të Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Nr.1 datë 06.09.2012.

- Veprime në kundërshtim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 neni 7, pika 1 “*inventari i aktiveve dhe detyrimeve*”.

- Veprime në kundërshtim me ligjin 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 612, datë 05.09.2012.

3......, me detyrë doganier në Degën e Doganës Tre Urat në cilësinë e ish- specialist Analizë Risku, Ap osteriori, Jurist, specialist Borxhi për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale:

-Veprime në kundërshtim me KD nenet, 18 pika 4, 245 pikat 1, 2 dhe 4; Udhëzimit nr. 4, date 04/08/2006 “Për Zbatimin Praktik të Procedurës së Evidentimit, Kontabilizimit dhe Vjeljes së Borxhit Doganor” me ndryshimet; Rregullores së Brendshme të D.P. Doganave nr. 10168, datë 07.06.2011, sipas trajtimit në faqet 45-47 në Raportin Përfundimtar të Auditimit

-Veprime në kundërshtim me KD nenet 273 pika.1, 273 pika 2 dhe 287.2; nenin 245, pika 4; ligjin 61 2012 “Për akcizat në RSH” nenin 85, pika 2 dhe nenin 99; VKM -së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor” neni 384.5/a. Për 6 raste sipas trajtimit në faqet 47-52 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për të meta dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë për 2 ish-punonjës të cituar në RPA, pasi nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Artan Mirashi, përgjegjes grupi, Aqif Klosi dhe Bashkim Shehu, më tej u shqy rtua nga Kry eauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Berat me shkresën nr. 575/9, datë 20.10.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, nga ku rezulton se janë zbatuar 8 masat organizative të rekomanduara. Janë nxjerrë vendimet e Kryetarit të Doganës për 3 masat administrative në përputhje me rekomandimin.

Për 4 masat për shpërblim dëmi në shumën 25,489,507 lekë të rekomanduara; për shumën 5,267,808 lekë nga 15 subjekte, ka dalë vendim i kryetarit të Doganës, për shumën 2,018,426 lekë dhe i është kërkuar zyrtarisht DPD verifikimi i faturave, për shumën 3,249,382 lekë nga 5 subjekte. Për shpërblimin e dëmit në masën 8,476,212 lekë nga 20 subjekte, i është kërkuar

zyrtarisht DPD saktësimi i shumës për nxjerrjen e vendimeve administrative, janë nxjerë vendimet për shumën 111,067 nga 3 subjekte dhe është dërguar zyrtarisht për interpretim në DPD për një subjekt për shumën 11,634,420 lekë.

Për të treja masat disiplinore të rekomanduara ka filluar procedimi disiplinor.

KONTROLLI I LARTË I SHITIT